

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ministri Malaj publikon pagat që kërkojnë magjistratët: Nga mbi 5 mijë euro deri në...
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/ministri-malaj-publikon-pagat-qe-kerkojne-magjistratet-efekti-ne-buxhet-arrin-ne-40-milione-euro-shtese-cdo-vit/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 17:02:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 17:01:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a51d4cf89c1b3daf1d1ec1ff9ac36f79fd03466a76771dd312b91e547508967d
TEKSTI	0eeb08cdc030b9788456fe1c49c69013a9c5773ae31eace602e53d2de97e28b5
PAMJA	0ec470cf24a69c9b75bed1ddff135401c0b5cff598d7c5cb0d872f071d62ee1f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5f3ffffb13677fb4bd4a93ca30f29b105e4e8331ad3e488f464851a9d518808b
E MËPARSHMJA	dcc844ec34fd48eb5a1d61e71f13bd6c23c974c7425cd69f2eb36480e30bab8b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5f3ffffb13677fb4bd4a93ca30f29b105e4e8331ad3e488f464851a9d518808b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

 [LEXONI LAJMET E FUNDIT](#)

 [Facebook Icon KOHA JONË NË FACEBOOK](#)

 [Facebook Icon KOHA JONË NË INSTAGRAM](#)

 [YouTube Icon KOHA JONË NË YOUTUBE](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 
- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo WEBTV](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

Ministri Malaj publikon pagat që kërkojnë magjistratët: Nga mbi 5 mijë euro deri në...

[Lajme](#) E Enjte, 10 Shtator 2026 19:01



Ministri i Financave, Petrit Malaj, ka bërë me dije se ndaj tij, Sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtorëve të Thesarit është depozituar kallëzim penal lidhur me pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Malaj thotë se Ministria ka refuzuar të ekzekutojë rritjen e pagave pa një vendim të Parlamentit. Sipas tij, kërkesat për rritje do t'i kushtonin buxhetit 40 milionë euro shtesë në vit, ndërsa rishikimi i pagave për periudhën 2023–2026 do të kishte një efekt prej 125 milionë eurosh. Ministri thekson se çështja pritet të adresohet më 17 shtator, përmes miratimit të ligjit përkatës në Parlament.

Postimi i plotë

 [Koha YouTube Channel](#)

Të kallëzohesh sepse po zbaton ligjin, nga garantët e barazisë para ligjit! Sot, në Ministrinë e Financave u depozitua një kallëzim penal për mua si titullar i institucionit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e thesarit në të gjithë Shqipërinë. Arsyeja: Kemi refuzuar të hapim dyert e thesarit të shtetit për të nxjerrë që aty pa vendim të Parlamentit një volum të konsiderueshëm parash, si shtesë rroge për gjyqtarët dhe prokurorët.

 [Swiss Digital Desktop Reklama](#)

Nuk dua të bëj asnjë polemikë me askënd dhe as të risqaroj pozicionin e Ministrisë së Financave, ndërkohë që është thënë publikisht nga qeveria shqiptare dhe përfaqësuesit e Parlamentit, se askush nuk do të pengojë adresimin e çështjes së pagave sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të ndodhë më 17 shtator, kur të miratohet ligji që i jep Ministrisë së Financave të drejtën administrative të veprimit. Por, kjo nuk i ka penguar përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor që të përshkallëzojnë konfliktin me ekzekutivin duke nënshkruar një kallëzim penal që do ta marrë me siguri historia. Ndërkohë unë sot dua t'u bëj me dije qytetarëve sa kushton kërkesa e kallzuesve të nderuar, sipas shkallës së pagave:

 [Swiss Digital Mobile Reklama](#)

Gjyqtar i Shkallës së Parë
Është: 376,381 Lekë
Kërkohet: 567,421 Lekë

Gjyqtar i Shkallës së Dytë
Është: 388,927 Lekë
Kërkohet: 586,335 Lekë

Gjyqtar i GJKKO
Është: 401,473 Lekë
Kërkohet: 605,350 Lekë

Efekti total në buxhetin e shtetit me këto kërkesa është 40 milionë euro shtesë, çdo vit. Por nuk mbyllet këtu. Magjistratët kërkojnë rishikim të pagave për periudhën 2023-2026 me një efekt në buxhetin e shtetit 125 milionë euro. Ndërkohë u them drejtorëve të Thesarit në të gjithë Shqipërinë dhe Sekretarit të Përgjithshëm, që sot u kallëzuan së bashku me mua, se duhet të vazhdojnë ta kryejnë detyrën e tyre me qetësi dhe pa u intimiduar, duke ruajtur gjithmonë me rigorozitet financat e shtetit, të udhëhequr nga ligji.

ETIKETA [Petrit Malaj](#)

SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)


 Logo KOHA JONË SONDAZH

A duhet liruar Erion Veliaj të drejtojë bashkinë nga zyra?

- ☐ Po
☐ Jo

Voto

Më shumë nga Lajme




[Trump ndez Konventën e Republikanëve në Teksas, Berisha: Dita e parë ...](#)




[Ambasadori gjerman, Karl Bergner: Reforma në Drejtësi faktor kyç në a...](#)




[Berisha takohet me senatorin Lankford dhe kongresmenin Hern në SHBA](#)



[Hipoteka/Projektligji parashikon vendosjen e gjobave nga 5 mijë deri ...](#)



[Rama poston fotot: Shkolla “Sejdi Dida” në Krumë merr pamje të re, mb...](#)



[Rrajca kundër shkrirjes së Prrenjasit, banorët kërkojnë qëndrim nga d...](#)

[LAJMET E FUNDIT](#)





Mbrojtja e Thaçit e quan “marrëzi ligjore” dosjen e prokurorisë, kërkon lirimin

3 minuta më parë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.